VENDIM
Nr. 202, datë 7.4.2023

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E MINISTRISË SË KULTURËS, PËR VITIN 2023, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT TEKNIK TË NDËRHYRJES EMERGJENTE NË OBJEKTIN, MONUMENT KULTURE, KATEGORIA I "URA E MATIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 84/2022, "Për buxhetin e vitit 2023", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e vitit 2023, në programin "Trashëgimia kulturore dhe muzetë", t'i shtohet fondi prej 57 515 644 (pesëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e pesëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e dyzet e katër) lekësh në shpenzime kapitale, për financimin e projektit teknik të ndërhyrjes emergjente në objektin, Monument Kulture, kategoria I "Ura e Matit".
2. Ky fond përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2023.
3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Kulturës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama